

ANALIZA E BUXHETIT TE BASHKISE DHE INSTITUCIONEVE TE VARESISE VITI 2013

Buxheti i Bashkisë dhe Institucioneve të Vartësisë për vitin 2013 është miratuar me VKB nr. 22 datë 29.3.2013. Zbatimi i këtij buxheti gjatë vitit është bazuar në ligje, VKM, udhëzime, VKB si dhe akte ligjore dhe nënligjore dhe konkretisht:

- Ligjin nr 119/2012 datë. 17.12.2012 "Për buxhetin e vitit 2013".
- Udhëzimin nr. 2 datë 6.02.2012 i Ministrisë së Financave «Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit»
- Udhëzimin plotësues nr. 1/1 datë 19.02.2013 i Ministrisë së Financave «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2013»
- Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".
- Ligjin 8652, dt 31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore".
- Ligjin nr 9632 datë. 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore".
- VKM nr. 518 datë 16.8.2012 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619 dt. 02.07.2008 të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin e funksioneve grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore".
- VKM nr. 586 datë 17.7.2013 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619 dt. 02.07.2008 të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin e funksioneve grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore".
- VKM nr. 929 datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", VKM nr. 826 datë 5.12.2011 "Për një ndryshim në VKM nr. 929 datë 17.11.2010 Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë , të ndryshuar".
- VKM nr 414 datë 27.6.2012 "Për disa ndryshime ne VKM nr. 1114 datë 30.7.2008 për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703 datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, nr. 9136 datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe nr. 7870 datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar", VKM nr. 445 datë 11.07.2012 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".
- VKM nr 581 datë 17.7.2013 "Për disa ndryshime ne VKM nr. 1114 datë 30.7.2008 për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703 datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, nr. 9136 datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe nr. 7870 datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar dhe VKM nr 414 datë 27.6.2012 "Për disa ndryshime ne VKM nr. 1114 datë 30.7.2008 për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703 datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, nr.

9136 datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nr. 7870 datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”, VKM nr. 573 datë 3.7.2013 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

- V.K.B. nr 19 dhe 20 dt. 29.03.2013 “Mbi miratimin e strukturës së administratës së Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë”.
- VKM nr. 502 datë 16.04.2008 “Për administrimin e personelit të konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar, etj.
- VKM nr. 591 datë 10.7.2013 “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013”.
- VKB të miratuara gjatë vitit, urdhra të Kryetarit të Bashkisë dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore të vitit 2013.

Burimet kryesore të financimit të Buxhetit për vitin 2013 kanë qenë:

- Të ardhurat e trashëguara të vitit 2012
- Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore
- Të ardhurat e institucioneve të vartësisë
- Transferta e pakushtëzuar

Për vitin 2013 të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore u planifikuan në vlerën 473,319 mijë lekë. Gjatë vitit 2013 ky plan pësoi ndryshime dhe shkoi në vlerën 477,174 mijë lekë. Realizimi gjatë vitit 2013 ka qenë në vlerën 284,668 mijë lekë ose në masën 59.6%.

Të ardhurat nga institucionet e vartësisë janë planifikuar në vlerën 14,419 mijë lekë dhe gjatë vitit 2013 ky plan pësoi ndryshime dhe shkoi në vlerën 15,115 mijë lekë. Realizimi ka qenë në vlerën 14,885 mijë lekë ose në masën 98.4%.

Në materialin e analizës së buxhetit do të paraqesim më të detajuar analizën e të ardhurave të bashkisë dhe Institucioneve të Vartësisë.

Burimet e financimit jepen si më poshtë:

Burimet e financimit	Vlera	% për çdo zë ndaj totalit
-Të ardhurat e trashëguara	55,641 mijë lekë	10%
-Transferta e pakushtëzuar	198,249 mijë lekë	35.8%
-Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	284,668 mijë lekë	51.4%
-Të ardhurat e institucioneve të varësisë	14,885 mijë lekë	2.7%
-Sponsorizime të ndryshme	99 mijë lekë	0.1%
Total	553,542 mijë lekë	100%

Shpenzimet e realizuara për vitin 2013 jepen si më poshtë:

Shpenzimet	Vlera	% për çdo zë ndaj totalit
-Shpenzime personeli	186,856 mijë lekë	36.5%
-Shpenzimet operative dhe shërbime publike	229,336 mijë lekë	44.8%
-Shpenzime (principali & interesi)	13,676 mijë lekë	2.8%
-Subvencione	5,456 mijë lekë	1%
-Transferta tek organizata të ndryshme	36,700 mijë lekë	7.1%


-Transferta tek individët	2,418 mijë lekë	0.5%
-Shpenzime kapitale	37,373 mijë lekë	7.3%
Total	511,815 mijë lekë	100%

Transferta e pakushtëzuar

Për vitin 2013 transfera e pakushtëzuar ka qenë në vlerën 177,165 mijë lekë. Sipas VKB nr. 65 datë 12.7.2013 "Për kalimin e transfertës së pakushtëzuar sipas urdhrit të MF nr. 10606/1 prot. datë 9.7.2013 nga Bashkia Korçë për UKKO, në favor të Bashkisë Korçë u kalua dhe vlera 21,084 mijë lekë. Ecuria e transfertës së pakushtëzuar jepet si më poshtë:

	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Transferta e pakushtëzuar	124,657	166,785	186,488	171,127	167,287	171,421	177,165
Total	124,657	166,785	186,488	171,127	167,287	171,421	177,165

Paraqitja grafike



Transferta e pakushtëzuar është përdorur sipas udhëzimit plotësues nr. 1/1 datë 19.2.2013 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2013 duke respektuar ndarjen në 3-mujore si më poshtë: tremujori i parë 30%, i dyti 20%, i treti 20% dhe i katërti 30%.

Në shpenzimet e personelit administrativ është përdorur 15% e kësaj transferte.

REALIZIMI I TE ARDHURAVE TE BASHKISE DHE INSTITUCIONEVE TE VARTESISE PER VITIN 2013

Në tabelën e mëposhtme jepet realizimi i të ardhurave të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë për vitin 2013

Emertimi	Bashkia	NSHP	Klubi Shmsportesh	Klubi Shmsportesh sponsorizim	Q e Kultures	NSHMAC	Sht e foshnjes	Klubi I futbollit	Total
Ardhurat	286,893,972.56	1,978,792.00	183,000.00	600,000.00	1,629,100.00	10,536,483.00	259,555.00	21,000.00	302,101,902.56
D ne buxhet	-893,796.00	-70,939.00	-17,000.00			-2,750.00	-112,738.50	-21,000.00	-1,118,223.50
5% gar pun	-1,332,096.00								-1,332,096.00

Vl e mb e Ardhurave	284,668,080.56	1,907,853.00	166,000.00	600,000.00	1,629,100.00	10,533,733.00	146,816.50	0.00	299,651,583.06
Celja Jan-Dhj	260,139,384.38	1,877,980.00	157,500.00	550,000.00	1,569,100.00	9,479,023.00	47,416.50		273,820,403.88
Te ardh te pashperndara	24,528,696.18	29,873.00	8,500.00	50,000.00	60,000.00	1,054,710.00	99,400.00	0.00	25,831,179.18

Sipas kësaj table, totali i të ardhurave të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë për vitin 2013 ka qenë 299,651,583.06 lekë, nga të cilat 273,820,403.88 lekë janë çelur dhe u përdorën për realizimin e shpenzimeve sipas buxhetit të miratuar për vitin 2013.

Totali i të ardhurave të trashëguara të vitit 2013 paraqitet në tabelën e mëposhtme në vlerën prej 41,726,908.91 lekë, nga të cilat 25,831,179.18 lekë janë nga të ardhurat e realizuara gjatë muajit dhjetor, 8,061,523.85 lekë të ardhura nga sponsorizimet dhe 7,602,197.88 lekë nga shpenzimet e fundvitit dhe do të përdoret për të shlyer detyrimet e vitit 2013.

Institucionet	Mbartur nga shpenzimet	Mbartur nga te ardhurat	Mbartur nga sp(ardh)	Mbartur nga sp(shp)	Te ardh te trash viti 2013
Cerdhja	122,349.00	65,080.00			187,429.00
Arsimi 9 vj	364,265.00	988,380.00			1,352,645.00
Arsimi I mesem	15,600.00	1,250.00			16,850.00
Arsimi prof	911,359.00				911,359.00
Klubi shumesportesh	277,051.00	8,500.00	50,000.00	15,355.00	354,906.00
Klubi I futbollit	227,735.00				227,735.00
Qendra e kultures	1,520,482.00	29,000.00			1,545,482.00
Teatri	401,463.00				401,463.00
Biblioteka	1,260,503.00	31,000.00			1,291,503.00
Njësia e Zbatimit të Projektit	46,084.00				46,084.00
NJMBQS	192,525.00				192,525.00
NSHP	2,262,755.00	29,873.00			2,292,628.00
Bashkia	82,779.38	24,528,696.18	7,913,023.85	37,853.00	32,562,352.41
Sherbimi urban	42,645.00				42,645.00
Shërbimi I Pastrimit	23,099.00				23,099.00
Sherbimifuneral	3.00				3.00
Qendra Rezidenciale	6,477.00				6,477.00
Qendra Ditore	10,686.00				10,686.00
Shtëpia e Foshnjes	24,591.50	900.00	98,500.00	137,046.00	261,037.50
Totali	7,792,451.88	25,682,679.18	8,061,523.85	190,254.00	41,726,908.91


PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I TË ARDHURAVE PËR VITIN 2013

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
1	Tatim mbi ndërtesën	44 000 000	45 728 925	104 %

Tatimi mbi ndërtesën për vitin 2013 është planifikuar 44.000.000 lekë dhe është realizuar në masën 104% ose në vlerë 45.728.925 lekë, shumë kjo e arkëtuar nga subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën 25.485.616 lekë , nga familjarët për vitin 2013 në vlerën 20.243.309 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tatimit mbi ndërtesën për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013:

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Tatim mbi ndërtesën	31.263.240	38.471.958	42.339.054	38.952.207	38.420.552	43.777.278	45.728.925




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
2	Tatim shitjeje pasuri e paluajtshme	3.300.000	6.461.126	196 %

Tatim shitje pasuri e paluajtshme e cila planifikohet dhe mblidhet nga agjenti tatimor i cili është ZVRPP Korçë, për vitin 2013 është planifikuar 3.300.000 lekë dhe është realizuar në masën 196 % ose e shprehur në vlerë 6.461.126 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tatim shitje pasuri e paluajtshme për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013 :

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Tatim shitjeje pasuri e paluajtshme	12.477.970	3.775.587	10.866.347	5.717.266	5.129.970	3.828.227	6.461.126



Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
3	Taksë Vendore B.V	118.400.000	82.769.863	70 %

Taksë vendore biznesi i vogël në buxhetin e vitit 2013 është planifikuar 118.400.000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2013 është në masën 70 % ose në vlerë 82.769.863 lekë.

Pavarësisht se biznesi i vogël gjithmonë është parë nga ana e Bashkisë Korçë si një partner në punësim dhe zhvillim, dhe viti 2013 ka qenë ndër vitet më të vështira prej vitit 2010 . Në subjektet e biznesit të vogël që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Bashkisë Korçë dhe jashtë saj është vënë re më tepër se kurrë mungesa e likuiditetit e cila është pasojë direkte e uljes së konsumit ose më saktë e rënies së fuqisë blerëse. Kjo rënie e fuqisë blerëse shpjegohet me rritjen e inflacionit pra “ me të njëjtën sasi lekësh konsumatorët kanë blerë me pak të mira në vitin 2013 sesa në ato paraardhëse” Po ta shikosh dhe gjatë vitit 2013 vazhdon të kemi një tendencë që shkon drejt negativitetit ndërmjet subjekteve që kanë çelur aktivitetin dhe atyre që e kanë mbyllur apo pezulluar atë.


Në mos realizimin e taksës vendore të biznesit të vogël për vitin 2013 kanë ndikuar dhe:

- a) Bazuar në Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” dhe Udhëzimin nr 655/1 datë 06.02.2007 në zbatim të tij paragrafi 5 ku thuhet se detyrimi vjetor për taksën vendore mbi biznesin e vogël përcaktohet nga zyra e taksave në bashki vetëm mbi bazën e qarkullimit vjetor të parashikuar për t’u realizuar gjatë vitit nga tatimpaguesi, parashikim i cili dorëzohet nga tatimpaguesi brenda datës 1 mars të çdo viti rezultoi se planifikimi ishte më tepër nga vetëdeklarimi i subjekteve të biznesit të vogël që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Bashkisë Korçë brenda datës 1 mars 2013.
- b) Ka vazhduar dhe gjatë vitit 2013 të kemi një tendencë që shkon drejt negativitetit ndërmjet subjekteve që kanë çelur aktivitetin dhe atyre që e kanë mbyllur apo pezulluar atë. Kështu gjatë vitit 2013 kanë aplikuar për mbyllje ose pezullim aktiviteti pranë Q.K.R sporteli Korçë një numër i konsiderueshëm subjektësh të biznesit të vogël që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Bashkisë Korçë, efekti i mbylljes ose pezullimit të aktivitetit të cilëve ka pasur ndikim në mos realizimin e planifikimit të taksës vendore të biznesit të vogël për vitin 2013.
- c) Pavarësisht përpjekjeve të Drejtorisë së të Ardhurave të Bashkisë Korçë për sensibilizimin e subjekteve të biznesit të vogël që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Bashkisë Korçë për të paguar këstin e katërt të taksës vendore brenda muajit dhjetor 2013 apo brenda vitit ushtrimor 2013, afati ligjor për pagesën e kështit të katërt të taksës vendore të vitit 2013 është jo më vonë se data 20 Janar 2014, për rrjedhojë ka subjekte të biznesit të vogël që këstet e taksës vendore i kanë paguar pas datës 31.12.2012 me një vlerë prej 3.296.250 lek.
- d) Si rezultat i fakteve të sipër përmendura por edhe nga kontaktet e përditshme me subjektet e biznesit të vogël por edhe të madh që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Bashkisë Korçë konstatojmë se viti 2013 sikurse edhe viti i mëparshëm është karakterizuar nga një mungesë e theksuar likuiditeti nga ana e biznesit, fakt i cili ka çuar në mos pagesën në kohë të kësteve të taksës vendore duke krijuar debitorë për taksën vendore të biznesit të vogël për vitin 2013.

Bazuar në realizimin e taksës vendore për vitin 2013 e cila është në vlerën 82.769.863 lekë, plus debitorët për taksën vendore për vitet paraardhëse, debitorët për vitin 2013, të cilat nuk u arkëtuan deri në datë 20.01.2014 për të cilët kanë filluar të aplikohen të gjitha masat shtërnguese bazuar legjislacionit tatimor në fuqi, shuma e të cilave është në vlerën 34.338.180 lekë, plus këstin e katërt të taksës vendore të pa paguar deri në datë 31.12.2013 me një vlerë prej 3.296.250 lekë. Nqs i mbledhim këto tre vlera të pasqyruara më sipër na del një shumë e cila përafrohet me parashikimin fillestar të taksës vendore të biznesit të vogël për vitin 2013.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës vendore të biznesit të vogël për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013 :

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Taksë Vendore B.V	108.073.520	114.076.833	108.354.935	96.085.337	93.874.914	89.192.648	82.769.863




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
4	Taksë Rregjistrimi e përvitshme (automjete)	23.500.000	21.497.777	91 %

Taksë regjistrimi e përvitshme e automjeteve e cila planifikohet dhe mbledhet nga agjenti tatimor i cili është D.R.SH.T.RR Korçë, për vitin 2013 është planifikuar 23.500.000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2013 është në masën 91 % ose në vlerë 21.497.777 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksë regjistrimi automjete për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 -2012 – 2013 :

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Taksë Rregjistrimi e përvitshme (automjete)	13.838.230	12.587.728	15.933.000	14.805.564	15.501.348	23.380.418	21.497.777




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
5	Tarifë Rregjistrim biznesi	3.000.000	2.770.000	92 %

Tarifë regjistrim biznesi për leje ushtrim veprimtarie për vitin 2013 është planifikuar 3.000.000 lekë dhe është realizuar në masën 92 % ose në vlerë 2.770.000 lekë. dhe është rezultat i regjistrimit të 182 subjekteve të reja gjatë vitit 2013 nga të cilat 129 subjekte kanë paguar tarifë regjistrimi 15.000 lekë, 41 subjekte 20.000 lekë, 6 subjekte 2.500 lekë dhe 6 subjekte kanë përfutur tarifë regjistrimi zero si rezultat i iniciativave fiskale të paketës fiskale 2013.

Bazuar në vitet paraardhëse por edhe punën e përditshme në terren pritshmëria jonë ishte që numri i subjekteve të reja që do të regjistroheshin gjatë vitit 2013 të ishte më e lartë sesa fakti i arkëtuar, gjë e cila nuk u realizua mbase edhe për vetë karakteristikat e vitit 2013 i cili u shoqërua me një tkurrje ekonomike dhe frenim të iniciativës së lirë nga ana e individëve të ndryshëm të cilët nuk riskuan për çeljen e veprimtarive të reja ekonomike.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksë regjistrim biznesi për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013 :

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Taksë Rregjistrimi e përvitshme (biznesi)	5.569.500	5.487.500	4.083.000	3.650.000	3.020.000	2.746.500	2.770.000




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
6	Taksë për Ndërtimet e reja	81.125.000	118.347	0.15 %

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitin 2013 është planifikuar 81.125.000 lekë, dhe realizimi i saj deri në fund të vitit është realizuar në masën 0.15 % ose në vlerë 118.347 lekë. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitet më përpara ka zënë një peshë mjaft të rëndësishme në të ardhurat e Bashkisë Korçë, duke u renditur në vendin e dytë pas taksës vendore të biznesit të vogël. Në mos realizimin e kësaj takse për vitin 2013, duke filluar që nga viti 2012 e më pas ka ndikuar mungesa e dhënies së lejeve të ndërtimit proces ky i lidhur drejtpërdrejt me biznesin e vogël dhe të madh si psh bizneset që tregëtojnë materiale ndërtimi, materiale elektrike, pajisje hidrosanitare etj duke ndikuar edhe në mos realizimin e taksës vendore të biznesit të vogël për keto vite.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksë për ndërtimet e reja për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013:

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Taksë për Ndërtimet e reja	14.305.700	35.628.087	27.692.002	71.591.960	67.162.277	4.929.863	118.347




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
7	Taksë ndikimi në infrastrukturë nga legalizimet	37.368.740	2.735.018,98	7 %

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2013 është planifikuar 37.368.740 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit është realizuar në masën 7 % ose në vlerë 2.735.018,98 lekë shifër e cila është 1.828.724,56 lekë më pak krahasuar me vitin paraardhës.

Planifikimi fillestar i kësaj takse prej 61.982.000 lekë i kryer në vitin 2009 u bë nga specialistët e Bashkisë Korçë të cilët krijuan dosjet për çdo objekt në proces legalizimi si dhe afatet kohore për kryerjen e këtij procesi bazuar në vlerat konform legjislacionit në fuqi në atë kohë në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet. Por kalimi i procesit të legalizimeve nga kompetencë e pushtetit vendor në atë të pushtetit qendror si dhe reduktimi i ndjeshëm me ligj gjatë vitit 2009 i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, bëri që shqyrtimi i dosjeve të krijuara nga strukturat përkatëse të Bashkisë Korçë me objektet në proces legalizimi të cilat ju kaluan ALUIZN –it Qarku Korçë për procedim të mëtejshëm, të ecte jashtëzakonisht ngadalë fakt i cili duket edhe në arkëtimet e kryera në lidhje me këtë taksë gjatë ketyre viteve. Procesi i legalizimeve filloi në fund të vitit 2008 dhe viti 2009 ishte viti i parë që nga ana jonë u planifikua taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet. Nga informacioni që disponojmë krahasuar me njësitë e tjera vendore të Shqipërisë, në Bashkinë e Korçës ky proces ka ecur me hapa jashtëzakonisht të ngadalta ndërkohë që duhet të kishte përfunduar, Pra nga planifikimi fillestar i kësaj takse prej 61.982.000 lekë i kryer në vitin 2009 ka ngelur një vlerë prej 34.633.927 lekë të pa arkëtuar. Shpresojmë që në vitin 2014 të arkëtojmë një pjesë të konsiderueshme të kësaj vlere të pa arkëtuar nga planifikimi fillestar, megjithëse edhe për vitin 2014 ashtu si edhe në vitin paraardhës zyra e ALUIZN –in Qarku Korçë nuk ka bërë ndonjë planifikim.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitet 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013 :

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Taksë ndikimi në infrastrukturë nga legalizimet	0	5243997	7045624	3088276	4671413.7	4563743.5	2735018.98




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
8	Tarifë Rregjistrimi për leje transporti	550.000	220.940	40%

Tarifë regjistrim leje transporti për vitin 2013 është planifikuar **550.000** lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit është realizuar në masën 40 % ose në vlerë **220.940** lekë. Tarifa për regjistrim leje transporti për vitin 2013 është realizuar në vlerë të vogël duke e krahasuar me vitet paraardhëse pasi sipas udhëzimit nr.15 datë 24.07.2007 “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR” i ndryshuar të MPPTT – së certifikimet e tyre do të paguheshin sipas kërkesës së subjektit 1-5 vjet. Vlen të përmendim këtu që dhe gjatë vitit 2013 pati një rregjistrim shumë të ulët kërkesash për autorizime qarkullim kamioni në qytet.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së regjistrim për leje transporti për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 -2012 – 2013:

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Tarifë Rregjistrimi për leje transporti	1.348.500	1.788.635	1.508.300	2.140.810	2.841.470	853.305	220.940




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
9	Taksë fjetje ne hotel	2.000.000	1.786.448	89%

Taksë fjetje në hotel për vitin 2013 është parashikuar 2.000.000 lekë dhe është realizuar në masën 89% ose në vlerën 1.786.448 lekë, këto nga subjektet me aktivitet hotel që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin administrativ të Bashkisë Korçë. Siç vihet re edhe nga grafiku duket qartë trendi në rritje i taksës së fjetjes në hotel sidomos në tre vitet e fundit 2011-2012 dhe 2013, kjo sigurisht për faktin se qyteti i Korçë është kthyer në një atraksion gjithmonë e më të vizitueshëm nga turistët brenda dhe jashtë vendit.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksë fjetje në hotel për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013:

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Taksë fjetje ne hotel	574.500	968.315	825.046	937.192	1.730.389	1.886.089	1.786.448




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
10	Taksë Therrje Bagëti	750.000	744.600	99 %

Taksë therrje bagëti për vitin 2013 është planifikuar 750.000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2013 është në masën 99 % ose në vlerë 744.600 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës therrje bagëti për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013 :

viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Taksë therrje bagëti	435.750	576.900	824.000	711.100	619.850	761.150	744.600




Nr	Lloji i Taksës ose Tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
11	Taksë Reklame	16.000.000	13.744.478	86 %

Taksë reklame për vitin 2013 është planifikuar 16.000.000 lekë dhe është realizuar në masën 86 % ose në vlerë 13.744.478 lekë. Siç pasqyrohet në tabelë ka një mos realizim prej 2.255.522 lekë shifër e cila justifikohet me mos pagimin e detyrimit në lidhje me taksën e reklamës nga ana e subjekteve që ushtrojnë aktivitet reklamues në territorin e Bashkisë Korçë deri në fund të vitit ushtrimor 2013 duke figuruar si debitorë pranë Drejtorisë së të Ardhurave të Bashkisë Korçë për vitin 2013 dhe në lidhje me ta kanë filluar të ndiqen procedurat e mbledhjes të detyrimeve gjatë vitit 2014 konform legjislacionit në fuqi.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës së reklamës për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013:

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Taksë reklame	6.230.540	10.884.190	11.017.000	14.558.562	13.365.875	13.103.438	13.744.478




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
12	Taksë Tabele	300.000	247.250	82 %

Taksë table për vitin 2013 është planifikuar 300.000 lekë dhe është realizuar në masën 82 % ose në vlerë 247.250 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës së tabelës për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013:

viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Taksë table	1.124.450	1.319.100	2.609.400	1.942.220	254.770	261.280	247.250


Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
13	Tarifë mur perimetral	680.000	0	0%



Tarifë mur perimetral për vitin 2013 është planifikuar 680.000 lekë, dhe nuk është arkëtuar asnjë e ardhur nga ky zë për vitin 2013.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës mur perimetral për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013:

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Tarifë mur perimetral	404.880	614.448	485.360	995.680	845.680	87.410	0




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
14	Taksë Tavoline	2.800.000	2.022.300	72 %

Taksë tavoline për vitin 2013 është parashikuar 2.800.000 lekë dhe është realizuar në masën 72 % ose në vlerën 2.022.300 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës së tavolinës për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013 :

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Taksë Tavoline	2.305.000	2.733.000	2.928.750	2.566.700	1.968.500	2.741.275	2.022.300




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
15	Tarifë Pastrimi	53.300.000	58.843.384.	110 %

Tarifë pastrimi për vitin 2013 është planifikuar 53.300.000 lekë dhe është realizuar në masën 110 % ose në vlerën 58.843.384 lekë pra siç shihet ka një realizim prej 5.543.384 lekë më tepër se planifikimi. Kjo shumë është arkëtuar nga subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën 26.912.210 lekë, nga familjet në vlerën 31.885.474 lekë dhe nga 24 institucione shtetërore në vlerën 45.700 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së pastrimit për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013:

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Tarifë Pastrimi	35.737.710	51.136.995	52.574.501	53.701.508	40.344.535	49.719.607	58.843.384




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
16	Tarifë shërbimi, vërtetime, çertifikata	7.455.319	5.925.621,18	79 %

Të ardhura të tjera (tarifa shërbimi, vërtetime, çertifikata, etj), për vitin 2013 është planifikuar 7.455.319 lekë dhe është realizuar në masën 79 % ose në vlerën 5.925.621,18 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifave të shërbimit, vërtetime, çertifikata, etj për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011- 2012 – 2013:

viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Tarifë shërbimi, vërtetime,	2.167.362	2.390.190	2.616.880	4.718.240	3.237.085	5.991.427,1	

çertifikata							5.925.621,18
-------------	--	--	--	--	--	--	--------------




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
17	Tarifë Parkimi	2.500.000	1.943.306	78%

Tarifë parkimi për vitin 2013 është planifikuar 2.500.000 lekë dhe deri në fund të vitit 2013 është realizuar në masën 78 % ose në vlerë 1.943.306 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së parkimit për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013:

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Tarifë Parkimi	3.021.330	3.343.130	3.197.520	4.233.170	2.779.935	2.422.740	1.943.306




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
18	Gjoha Policia Bashkiake	500.000	19.000	4 %

Gjopa Policia Bashkiake për vitin 2013 është planifikuar 500.000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2013 është në masën 4% ose në vlerën 19.000 lekë. Vlera e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake për vitin 2013 dhe ato të mbartura nga vitet e mëparshme dhe të kontabilizuara nga Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Korçë është 88.000 lekë, pjesa tjetër e tyre 69.000 lekë nuk janë arkëtuar brenda afatit ligjor dhe për to do ndiqet procedura ligjore bazuar në legjislacionin në fuqi dhe mendojmë të arkëtohen për vitin 2014.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të gjopa policia bashkiake për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013 :

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Gjopa Policia Bashkiake	410.136	451.651	312.000	334.600	64.500	42.000	19.000




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
19	Gjopa biznesi i vogël	700.000	757.239	108 %

Gjopa biznesi i vogël për vitin 2013 është planifikuar 700.000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2013 është në masën 108 % ose në vlerën 757.239 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të gjobave të biznesit të vogël për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013:

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Gjopa biznesi i vogël	730920	681336	1698480	1230374	675761	619873	757239




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
20	Gjoba Inspektoriati i Ndërtimit	2.000.000	2.030.000	102 %

Gjoba të Inspektoriatit të Ndërtimit për vitin 2013 është planifikuar 2.000.000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2013 është në masën 102 % ose në vlerë 2.030.000 lekë shifër e cila është 30.000 lekë më tepër se planifikimi dhe 910.000 lekë më tepër krahasuar me realizimin e vitit 2012. Vlera e gjobave të vendosura nga inspektorët e Inspektoriatit të Ndërtimit për vitin 2013 dhe ato të mbartura nga vitet e mëparshme dhe të kontabilizuara nga Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Korçë është 9.020.000 lekë, ndërsa pjesa tjetër e tyre 6.990.000 lekë nuk janë arkëtuar brenda afatit ligjor dhe si të tilla procedura për vjeljen e tyre i ka kaluar Drejtorisë Juridike të Bashkisë Korçë bazuar në legjislacionin në fuqi dhe mendojmë të arkëtohen për vitin 2014.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të gjobave të inspektoriatit të ndërtimit për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013 :

viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Gjoba Inspektoriati i Ndërtimit	399.600	800.000	880.000	200.000	150.000	1.120.000	2.030.000




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
21	Gjoba të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit	250.000	55.000	22 %

Gjoba të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit për vitin 2013 është planifikuar 250.000 lekë, dhe është realizuar në masën 22 % ose në vlerën 55.000 lekë. Vlera e gjobave të vendosura nga inspektorët e Drejtorisë së Kontrollit të Territorit për vitin 2013 dhe ato të mbartura nga vitet e mëparshme dhe të kontabilizuara nga Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Korçë është 390.000 lekë, ndërsa pjesa tjetër e tyre 335.000 lekë nuk janë arkëtuar brenda afatit dhe për to do ndiqet procedura ligjore bazuar në legjislacionin në fuqi dhe mendojmë të arkëtohen për vitin 2014.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të gjobave të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit për vitet 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013:

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Gjoba të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit		41.600	52.000	60.000	72.000	125.000	55.000

Gjopa të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
22	Qera Objekti	733.260	819.935	112 %

Qera objekti për vitin 2013 është planifikuar 733.260 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2013 është në masën 112 % ose në vlerën 819.935 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të zërit qera objekti për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013:

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Qera objekti	1.060.643	940.513	2.360.264	747.319	672.005	1.550.338	819.935


Qera objekti



Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
23	Qera sipërmarrje	432.000	396.000	92 %

Qera sipërmarrje për vitin 2013 është planifikuar 432.000 lekë dhe është realizuar në vlerën 396.000 lekë në masën 92 %. Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të zërit qera sipërmarrje për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013:

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Qera sipërmarrje	1.418.904	1.033.707	1.034.267	1.100.336	0	864.000	396.000




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
24	Tarifë plan vendosje	100 000	0	0 %

Tarifë plan vendosje për vitin 2013 është planifikuar 100.000 lekë, dhe është realizuar në masën 0 % ose në vlerë 0 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së plan vendosjes për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013 :

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Tarifë plan vendosje	162.000	105.100	153.000	177.000	96.000	0	0




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
25	Tarifë Ndiriçimi	15.650.000	17.774.748,7	114 %

Tarifë ndiriçimi për vitin 2013 është planifikuar 15.650.000 lekë dhe është realizuar në masën 114 % ose në vlerën 17.774.748,7 lekë. Kjo shumë është arkëtuar nga subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën 5.748.879,7 lekë , nga familjet në vlerën 11.790.869 lekë dhe nga institucionet shtetërore në vlerën 235.000 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së ndiriçimit për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013:

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Tarifë Ndiriçimi	7.905.700	12.206.315	13.306.880	14.461.572	11.178.626	15.424.960	17.774.748,7




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
26	Tarifë Gjellbërimi	10.650.000	12.084.451,7	113 %

Tarifë gjelbërimi për vitin 2013 është planifikuar 10.650.000 lekë, dhe është realizuar në masën 113 % ose në vlerën 12.084.451,7 lekë. Kjo shumë është arkëtuar nga subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën 3.374.931,7 lekë, nga familjet në vlerën 8.474.520 lekë dhe nga institucionet shtetërore në vlerën 235.000 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së gjelbërimit për vitet 2007 – 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013:

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Tarifë Gjelbërimi	3.654.900	6.983.000	8.491.125	9.119.317	7.270.496,5	10.545.989	12.084.451,7




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
27	Tarifë servituti	800.000	337.820	42 %

Tarifë servituti për vitin 2013 është planifikuar 800.000 lekë dhe është realizuar në masën 42 % ose në vlerën 337.820 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së servitutit për vitet 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013:

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Tarifë servituti		621.140	692.280	684.932	301.860	377.060	337.820




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
28	Tarifë përdorimi i tregut të lirë të qytetit	6.000.000	501.160	8 %

Tarifë përdorimi tregu i lirë i qytetit për vitin 2013 është planifikuar 6.000.000 lekë dhe është realizuar në masën 8 % ose në vlerën 501.160 lekë, shifër e cila është 5.498.840 lekë më pak krahasuar me planin.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së përdorimit të tregut të lirë të qytetit për vitet 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013:

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Tarifë përdorimi i tregut të lirë të qytetit		16.511.520	14.858.843	11.953.790	10.721.136	5.316.780	501.160




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
29	Tarifë leje përdorimi kantina	1.000.000	824.450	82 %

Tarifë leje veprimtarie kantina për vitin 2013 është planifikuar 1.000.000 lekë dhe është realizuar në masën 82 % ose në vlerën 824.450 lekë, në mosrealizim e kesaj tarife gjatë vitit 2013 ka ndikuar një subjekt i cili ka aplikuar për mbyllje aktiviteti dhe një subjekti tjetër po gjate vitit 2013 i është djegur kantina .

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës leje veprimtarie kantina për vitet 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013:

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Tarifë leje përdorimi kantina		1.512.800	1.303.980	1.134.000	948.600	1.081.351	824.450




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
30	Tarifë për ekspozim malli jashtë dyqanit	1.500.000	714.750	48 %

Tarifë për ekspozim malli jashtë dyqanit për vitin 2013 është planifikuar 1.500.000 lekë dhe është realizuar në masën 48 % ose në vlerën 714.750 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës për ekspozim malli jashtë dyqanit për vitet 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013:

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Tarifë për ekspozim malli jashtë dyqanit		2.143.417	752.540	799.200	843.264	981.150	714.750



Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
31	Taksë Zënie Hapesira Publike	400.000	355.005	89 %

Taksë për zënie hapësire publike për vitin 2013 është planifikuar 400.000 lekë dhe është realizuar në masën 89 % ose në vlerën 355.005 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës për zënie hapësire për vitet 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013 :

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Takse zënie hapësire publike	0	0	0	0	0	283.457	355.005




Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
32	Tatim mbi Tokën Bujqësore	730.000	439.137	60 %

Tatim mbi tokën bujqësore për vitin 2013 është planifikuar 730.000 lekë dhe është realizuar në masën 60 % ose në vlerën 439.137 lekë. Në lidhje me debitorët e krijuar kanë filluar të ndiqen procedurat e mbledhjes të detyrimeve gjatë vitit 2014 konform legjislacionit në fuqi.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tatimit mbi tokën bujqësore për vitet 2008 – 2009 – 2010 – 2011 – 2012 – 2013:

viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Tatim mbi token bujqësore						3.760.957	439.137



Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
33	Takse e perkohshme per linjat ajrore dhe tokesore	2.000.000	0	0 %

Taksa e perkohshme për linjat ajrore dhe tokësore për vitin 2013 është planifikuar 2.000.000 lekë dhe gjatë vitit 2013 nuk ka pasur asnjë arktëmin për këtë taksë.

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
34	Të ardhura nga qeratë, banesa sociale	6.700.000	0	0 %

Të ardhurat nga qeratë, banesat sociale për vitin 2013 është planifikuar 6.700.000 lekë dhe gjatë vitit 2013 nuk ka pasur asnjë arkëtimin për këtë taksë pasi dhe po gjatë këtij viti nuk u bë i mundur dhënia me qera e këtyre banesave.

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
35	Të ardhura nga shitja e njësive të shërbimit	30.000.000	0	0 %

Të ardhurat nga shitja e njësive të shërbimit për vitin 2013 është planifikuar 30.000.000 lekë dhe gjatë vitit 2013 nuk ka pasur asnjë arkëtim për këtë taksë pasi dhe po gjatë këtij viti nuk u bë e mundur shitja e këtyre njësive të planifikuara.

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2013	Realizimi 2013	Përqindja
36	Shitje troje	0	0	0 %

Shitje troje për vitin 2013 nuk është planifikuar dhe gjatë vitit 2013 nuk ka pasur asnjë arkëtim për këtë taksë.

REALIZIMI I SHPENZIMEVE TE BASHKISE PER VITIN 2013**Shpenzime për paga**

Shpenzimet për paga për punonjësit e administratës së Bashkisë dhe Institucioneve të Vartësisë janë realizuar në bazë të VKM nr. 518 datë 16.8.2012 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619 dt. 02.07.2008 të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, VKM nr. 586 datë 17.7.2013 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619 dt. 02.07.2008 të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” si dhe të VKM nr. 826 datë 5.12.2011 “Për një ndryshim në VKM nr. 929 datë 17.11.2010 Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë , të ndryshuar”.

Numri i punonjësve të administratës së Bashkisë për vitin 2013 ka qene 132.

Fondi i planifikuar për paga për vitin 2013 ishte në vlerën 76,801 mijë lekë. Gjithashtu duke iu referuar VKM nr. 826 datë 5.12.2011 “Për një ndryshim në VKM nr. 929 datë 17.11.2010 Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë të ndryshuar si dhe sipas Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë fondi i veçantë u përdor edhe për:

-136 mijë lekë për zhvillimin e aktivitetit me rastin e 8 marsit.

-201 mijë lekë u përdor për shpërblim dalje në pension për 5 punonjës

-30 mijë lekë ndihmë për fatkeqësi

Fondi i planifikuar i pagave me keto ndryshime shkoi në vlerën 76,415 mijë lekë. Realizimi për vitin 2013 ka qenë në vlerën 73,961 mijë lekë ose 96.8%.

Shpenzime për sigurime shoqërore

Fondi i planifikuar për vitin 2013 ka qenë në vlerën 12,521 mijë lekë. Realizimi i këtij fondi ka qenë në vlerën 12,168 mijë lekë ose 97%. Ky fond u përdor sipas VKM nr 581 datë 17.7.2013 “Për disa ndryshime ne VKM nr. 1114 datë 30.7.2008 për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703 datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, nr. 9136 datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nr. 7870 datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar dhe VKM nr 414 datë 27.6.2012 “Për disa ndryshime ne VKM nr. 1114 datë 30.7.2008 për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703 datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, VKM nr. 445 datë 11.07.2012 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” si dhe VKM nr. 573 datë 3.07.2013 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

Shpenzimet operative (mallra dhe shërbime)

Fondi I planifikuar për shpenzime operative gjatë vitit 2013 ka qenë 45,943 mijë lekë dhe gjatë vitit ky fond ka pësuar ndryshime duke shkuar në 43,948 mijë lekë nga të cilat 38,276 mijë lekë ka qenë fondi I planifikuar I shpenzimeve operative për vitin 2013 dhe 5,672 mijë lekë kanë qenë detyrime nga viti 2012.

Realizimi I shpenzimeve operative për vitin 2013 ishte 24,428 mijë lekë ose 55.6%, në të cilën përfshihet edhe detyrimet e vitit 2012 prej 5,668 mijë lekë.

Analiza e detajuar e realizimit të shpenzimeve operative jepet në tabelën e mëposhtme.

000/lekë

	Fakt 2012	Det 2012	Fakt det	PI 2013	PI nd 13	Fakt 12 m	Det 13	Fakt + det	P13-F	%
TELEKOM+POSTA	2,245	73	73	2,300	2,100	1,410	39	1,449	690	68.2%
ABONIM INTERNET ADSL	247	28	24	300	300	286		286	18	94.5%
TELEFON PA PAGESE	19	1	1	35	35	3		3	32	11.1%
ENERGJIA ELEKTRIKE	2,101	8	8	2,486	2,486	2,029		2,029	457	81.7%
PAGESE UJI	1,475	0		1,590	490	378		378	112	77.1%
UDHETIME DHE DIETA	718	0		700	700	351	188	539	349	50.1%
RIPARIM E PAJISJE MAKINASH	499	30	30	450	450	236	186	422	214	55.4%
KARBURANT MAKINA+NGROHJE	6,672	1,901	1,901	7,000	7,000	4,967	2,021	6,988	2,033	77.2%
PRODH I REV,BROSH,PRODH, TRANS SPOT, ABONIME	2,233	1,396	1,396	3,000	2,680	140	614	754	2,540	37.7%
MEREMETIME TE NDRYSHME	67	247	247	250	250	0	130	130	250	49.7%
SHPENZIME PRITJE	145	9	9	150	150	10		10	140	11.9%
MATERIALE ELEKTRIKE DHE HIDRAULIKE	244	32	32	300	300	92	159	251	208	37.3%
VEESHJE,UNIFORMA POLICIA	313	0		350	350	0		0	350	0.0%
SIGURACION MAKINE NDERTESE DHE KONTROLL TEKNIK	94	19	19	450	450	62	30	92	388	17.3%
SHPENZIME TE TJERA	875	229	229	800	800	307	65	372	493	52.1%
ORGANIZIMI FESTES 8 MARSIT	155	0		0	155	136		136	19	87.7%
SHPENZIME Q.K.P. M.POTER	321	181	181	500	500	497		497	3	99.6%
LETER SHKRIMI FOTOKOPJIMI KANCELARI	514	8	8	600	400	406	25	431	-6	101.5%
MATERIALE KONSUMI	150	0		200	200	83	45	128	117	41.5%
RIPARIM FOTOKOPJE DHE PAISJE TE NDRYSHME	59	0		150	350	49	198	247	301	14.0%
TELEFONI CELULAR	46	3	3	48	48	31		31	17	66.7%
RUAJTJA E BASHKISE ETJ	2,772	486	486	3,575	3,575	2,333	638	2,971	1,242	69.4%
BOJE PRINTERI E FOTOKOPJUES	434	40	40	700	520	443	70	513	77	86.3%
SHPENZIME PER SHKOLLEN E MALTES	745	0		600	600	600		600	0	100.0%
VENDIME GJYQESORE	4,300	0		9,351	9,351	3,048		3,048	6,303	32.6%
SHPERBLIM KESHILLI KULTURES	68	79	79	158	158			0	158	33.3%
SHPERBLIM KESHILLI TEKNIK	102								0	
REGJISTRIMI PRONAVE BASHKI	232	0		400	200	21		21	179	10.5%
BLLOQE ADMINISTRATIVE	437	73	73	400	400	205	45	250	195	58.8%
MAT PROMOCIO (FTESA, FLETAPALOSJE,KARTOLINA)	666	373	373	750	750	28	218	246	722	35.7%
MATERIALE NJOFTIMI DHE INFORMACION	83	206	206	200	200	0		0	200	50.7%
BOTIM LIBRI GUIDE KORCA	120								0	
BLERJE MALLRA USHQIMORE	346								0	
SHP MIREMB E PROGRAMIT TE MENAXHIMIT TE TAKSAVE				475	475			0	475	0.0%
TOTAL SHPENZIME OPERATIVE	29,497	5,422	5,418	38,268	36,423	18,151	4,671	22,822	18,276	56.3%
Projekte	899	250	250	1,853	1,853	609	0	0	1,244	40.8%
SHER TE PRINTIMIT DHE PUBLIKIMIT	599	250	250	440	400	182			218	66.5%

SHPEN PJESMARRJE KONFERENCA				20	0				0	
SHPENZIME PRITJE PERCJELLJE				373	373	368			5	98.7%
SHPENZIME QERAMARRJE				1,000	1,060	59			1,001	5.6%
SHPENZIME TE TJERA				20	20	0			20	0.0%
SHPENZIME UDHETIMI FLUTURIMET E LIRA	300				0				0	
TOTALI SHPENZIME OPERATIVE+PROJEKTE	30,396	5,672	5,668	40,121	38,276	18,760	4,671	22,822	19,520	55.6%


Siç shihet nga tabela e mësipërme realizimi i buxhetit është në masën 55.6% dhe vlera prej 4,671 mijë lekë përbën detyrime të vitit 2013 të cilat do të mbarten në vitin 2014 dhe do të shlyhen në buxhetin e po këtij viti.

Më poshtë po japim të detajuar tabelën e realizimit të energjisë elektrike, ujit dhe telefonit për vitin 2013.

Realizimi i energjisë elektrike të Bashkisë është në masën 82% dhe jepet sipas tabelës së mëposhtme.

Nr		Fakti 2012	PI 2013	Fakt 2013	Dif P13-F13	%
1	BASHKIA KORCE	1,214,513	1,260,000	1,076,989	183,011	85%
2	RAJONI NR. 1	71,575	78,120	65,360	12,760	84%
3	RAJONI NR. 3 (AGJENSIA)	49,752	67,200	49,483	17,717	74%
4	PAZARI I PESHKUT	41,122			0	
5	DREJTORIA TAT-TAKSA	249,554	285,600	222,390	63,210	78%
6	SHTEPJA RUMUNE		58,800	4,080	54,720	7%
7	ANTENA	25,106	47,880	4,072	43,808	9%
8	GARAZHET	4,135				0%
9	GJYKATA/RAJONI 2	445,681			0	
10	RAJONI NR. 2		249,960	201,623	48,337	81%
11	GJYKATA (BASHKI)		438,000	404,987	33,013	92%
	TOTALI	2,101,438	2,485,560	2,028,984	456,576	82%


Paraqitja grafike



Realizimi I konsumit të ujit është në masën 77%.

Nr.		Fakt 12m	PI 2013	PI nd 2013	Fakti 12	Dif P13-F13	%
1	Bashkia Korce (drejt e te ardh)	249,219	280,000	335,000	311,388	23,612	93%
2	Rajoni nr. 1	9,614	15,000	15,000	7,410	7,590	49%
3	Rajoni nr. 2 (zyrat)	112,098	85,000	85,000	19,506	65,494	23%
4	Rajoni nr. 3	20,905	25,000	45,000	38,910	6,090	86%
5	Merkato e mishit	78,345	150,000			0	
6	Tregu fshatar	380,594	450,000			0	
7	Cezma publike	545,880	650,000			0	
8	Tregu I peshkut	72,748	75,000			0	
9	shtepia rumune	5,638	10,000	10,000	1,440	8,560	14%
	Total	1,475,041	1,740,000	490,000	378,654	111,346	77%

Paraqitja grafike



Realizimi I shpenzimeve telefonike ka qenë në masën 67%.

Nr.	Telefoni	Kujt I perket	Fakt 2012	PI 2013	PI nd. Sipas VKM	Fakt 2013	P13-F13	%
1	42004	Kryetari	361,392	300,000	212,516	151,347	61,169	71%
2	42082	Kryetari (fax)	24,960	25,000	19,657	19,200	457	98%
3	42590	Drejtoria e Finances	74,145	72,000	80,640	75,241	5,399	93%
4	42951	Sekretari KB	50,365	50,000	35,642	33,099	2,543	93%
5	42966	Koordinim Zhvillimi	24,960	25,000	19,657	19,200	457	98%

6	43032	Shef Kabineti	27,477	30,000	35,630	35,014	616	98%
7	43042	Personeli	58,087	60,000	37,871	20,628	17,243	54%
8	43044	Zv/Kryetari	86,461	90,000	34,575	31,469	3,106	91%
9	43047	Gjendja Civile	31,985	32,000	23,782	20,451	3,331	86%
10	43051	Numer I lire centrali	57,158	60,000	37,157	19,200	17,957	52%
11	43055	Drejtoria e Auditimit	25,104	26,000	20,157	19,200	957	95%
12	43061	Rajoni nr. 2	30,588	30,000	28,528	27,284	1,244	96%
13	43127	Rajoni nr. 3	32,873	35,000	30,275	28,780	1,495	95%
14	43212	Zv/Kryetari	113,446	110,000	78,323	65,115	13,208	83%
15	43249	Policia Bashkiake	31,187	30,000	25,031	24,474	557	98%
16	43353	Sekretare e Kryetarit	581,292	500,000	336,531	321,514	15,017	96%
17	43362	Rajoni nr. 1	35,294	35,000	33,134	32,526	608	98%
18	43382	Informacioni	24,160	25,000	19,657	19,200	457	98%
19	44816	Drejtoria e Urbanistikes	24,960	25,000	19,657	19,200	457	98%
20	44851	Drejtoria e Puneve Publike	27,051	30,000	24,958	24,241	717	97%
21	45755	Arkivi	57,241	60,000	27,813	25,807	2,006	93%
22	47631	Drejtoria e Personelit	28,572	55,000	48,289	45,899	2,390	95%
23	50277	Drejtoria e Perkrahe Sociale	62,797	65,000	38,958	38,622	336	99%
24	52802	Inspektoriati I Nderimit	27,758	30,000	24,281	23,331	950	96%
25	51844	Drejtoria e te ardhurave	41,556	40,000	34,045	33,183	862	97%
26	42133	Mbrojtja nga dhuna	35,669	40,000	27,407	23,814	3,593	87%
27		Sherbime postare	268,122	220,000	220,000	213,726	6,274	97%
		Totali	2,244,660	2,100,000	1,574,171	1,410,765	163,406	90%

Përsa l përket shpenzimeve telefonike për vitin 2013 është zbatuar edhe VKM “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013”, në të cilën duke filluar nga data 15.7.2013, pika 4, fondet e përdorura për pagesën e telefonisë fikse, për periudhën e mbetur, reduktohen në masën 50% në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nëpërmjet përgjysmimit të limiteve mujore për çdo përdorues.

HUAMARRJA VENDORE (KREDIA)

Gjatë vitit 2013 ka vazhduar shlyerja e kështit të parë të dytë dhe të tretë të kredisë. Kjo pagesë është bërë sipas kontratës së lidhur midis Bashkisë Korçë dhe Pro Credit Bank dhe planit të pagesave. Më poshtë po paraqesim të detajuar shlyerjen e kredisë.

- ✓ Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e parë të kredisë gjatë vitit 2010 është: principi në vlerën 45.000.000 lekë dhe interesi në vlerën 21.625,908.13 lekë.

Për shlyerjen e këtij disbursimi është paguar për periudhën 2010-2013

vlera prej 11,014 mijë lekë (interesi) dhe principi në vlerën 10,639 mijë lekë

- ✓ Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e dytë të kredisë gjatë vitit 2011 është: principali në vlerën 23.800.000 lekë dhe interesi në vlerën 11.312.744.33 lekë.

Për shlyerjen e disbursimit të dytë lekë është paguar për periudhën 2011-2013

vlera prej 4,919 mijë lekë (interesi) dhe principali në vlerën 4,699 mijë lekë

- ✓ Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e tretë të kredisë gjatë vitit 2012 është: principali në vlerën 23.800.000 lekë dhe interesi në vlerën 11.261.663.33 lekë.

Për shlyerjen e disbursimit të tretë është paguar për periudhën 2012-2013

vlera prej 2,399 mijë lekë (interesi) dhe principali në vlerën 1,983 mijë lekë.

Realizimi i kredisë për vitin 2013 jepet si më poshtë:

	PI 2013	Fakt 2013
SHLYERJA E KREDISE 2013	13,720	13,676
INTERESI	6,576	6,532
PAGESE PRINCIPALI	7,144	7,144

Transferta tek organizatat

Fondi i planifikuar për transfertat tek organizatat e ndryshme ka qenë në vlerën 7,977 dhe gjatë vitit 2013 ky fond pësoi ndryshime dhe shkoi në vlerën 32,516 mijë lekësh. Në këtë vlerë është përfshirë vlera prej 21,084 mijë lekë (transfertë e pakushtëzuar) ku sipas VKB nr. 65 datë 12.7.2013 iu kalua për llogari të UKKO ,

vlera prej 1,455 mijë lekësh sipas VKB nr. 62 datë 12.7.2013 shtesë e kontributit financiar i Bashkisë për UKKO për vitin 2013,

si dhe vlera prej 2,000 mijë lekësh sipas VKB nr. 63 datë 12.7.2013 për organizimin e “Sumer Fest”.

Realizimi i transfertës tek organizatat e ndryshme për vitin 2013 ka qenë 30,550 mijë lekë e detajuar si më poshtë:

-25,689 mijë lekë transfertë për UKKO

- 1,660 mijë lekë transferta për KRËM

- 650 mijë lekë sipas projektit Fuqizimi i fëmijëve romë iu transferua Fondacionit Misioni Emanuel me urdhër pagesën nr. 466 datë 28.10.2013 dhe me urdhër pagesën nr. 564 datë 13.12.2013.

-551 mijë lekë sipas projektit Qendër komunitare për të moshuarit iu transferua Fondacionit Kennedy me urdhër pagesën nr. 465 datë 28.10.2013. Vlera prej 450 mijë lekësh përbën detyrim i cili do të shlyhet gjatë vitit 2014.

- 2,000 mijë lekë pagesa për Summer fest sipas VKB nr. 63 datë 12.7.2013 për organizimin e “Sumer Fest”.

Transferta tek individët

Fondi i planifikuar për transfertat tek individët ka qenë në vlerën 660 mijë lekë dhe gjatë vitit ky fond pësoi ndryshime dhe shkoi në vlerën 1,041 mijë lekë.

Realizimi për vitin 2013 ka qenë 665 mijë lekë si më poshtë:

-221 mijë lekë transfertë tek individët për dalje në pension për 5 punonjës

- 30 mijë lekë transfertë tek individët për raste fatkeqësish

-150 mijë lekë dhënie ndihmë financiare për shpenzime funerale invalidi i luftës

-360 mijë lekë bonus transporti për Kryetarin e Bashkisë

Fondi i emergjencave civile

Fondi i planifikuar për emergjencat civile për vitin 2013 ka qenë në vlerën 190 mijë lekë. Ky fond u realizua në vlerën 130 mijë lekë e detajuar si më poshtë:

10 mijë lekë ndihmë financiare Znj. Alma Iljaz sipas VKB nr. 35 datë 25.4.2013

120 mijë lekë ndihmë financiare për familje të dëmtuara nga zjarri sipas VKB nr. 36 datë 25.4.2013.

Kontributi i qarkut

Fondi i planifikuar për kontributin e qarkut për vitin 2013 ishte 11,000 mijë lekë dhe realizimi ka qenë në vlerën 5,900 mijë lekë. Vlera prej 4,000 mijë lekë do të jetë detyrim i vitit 2013 dhe do të shlyhet gjatë vitit 2014 duke iu referuar udhëzimit nr. 2 datë 6.2.2012 i MF "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit."

Këshilltarët

Planifikimi për pagesën e këshilltarëve gjatë vitit 2013 ka qenë në vlerën 4,830 mijë lekë. Realizimi ka qenë në vlerën prej 4,796 mijë lekë.

SHERBIMET PUBLIKE

1. **Shërbimi I transportit qytetës** gjatë vitit 2013 u planifikua me një vlerë 5,500 mijë lekësh dhe jepet në formë subvencioni. Realizimi ka qenë në vlerën 5,456 mijë lekë. Ky shërbim mbështetet në realizimin e zërave të mëposhtëm :

- a. Itenerari I përcaktuar në kontratë I mjeteve
- b. Orari I shërbimit të këtij transporti
- c. Numri I mjeteve në linjë
- d. Fluksi I kalimit të autobusëve nëpër stacionet e përcaktuara
- e. Qëndrimi i mjeteve nëpër stacionet e përcaktuara

2. **Shërbimi funeral dhe mirembajtja e varrezave publike dhe ato të dëshmorëve**

Fondi I planifikuar për vitin 2013 ka qenë 4,433 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 3,660 mijë lekë ose në masën 82.5%. Vlera prej 275 mijë lekë përbën detyrim të vitit 2013 e cila do të shlyhet gjatë vitit 2014. Ky shërbim konsiston në zërat e mëposhtëm :

- a. Pastrim parcelash, rrugë dhe sheshe të brendshme ndërmjet blloqeve të varrimit
- b. Mirëmbajtje drurë dhe shkurre dekorative
- c. Mbjellje drurë dekorative
- d. Mirëmbajtje dhe krijim gardhe te gjelbërt me ligustër dhe lavandinë
- e. Kositje, grumbullim dhe transport bari
- f. Mirëmbajtje bordure betoni të brendshme
- g. Lyerje me gëlqere të bordurave dhe pemëve në varrezat publike dhe të dëshmorëve
- h. Ruajtja e objektit në varrezat publike dhe të dëshmorëve
- i. Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve
- j. Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve nga amortizimi
- k. Mirëmbajtje e murit rrethues
- l. Konsumi I ujit të pijshëm për mirembajtje dhe nevojat e qytetarëve

3. **Shërbimi I pastrimit të qytetit** gjatë vitit 2013 ky shërbim është një nga shërbimet më të rëndësishme që kryen Bashkia në shërbim të komunitetit. Fondi I planifikuar për vitin 2013 ka qenë 87,571 mijë lekë nga të cilat 28,669 mijë lekë ishin detyrim I vitit 2012 dhe 58,902 mijë lekë fondi I planifikuar në vitin 2013, kurse realizimi ka qenë në vlerën 37,187 mijë lekë. Vlera prej 46,864 mijë lekë përbën detyrim të vitit 2013 e cila do të shlyhet gjatë vitit 2014. Realizimim ka qenë në masën 42%.

Objekti I këtij shërbimi është:

-pastrimi I rrugëve dhe trotuareve,

-evadimi I mbetjeve urbane në qytetin e Korçës dhe përpunimi I tyre,

-lagia e rrugëve,

-evadimi I dëborës në stinën e dimrit dhe hedhja e kripës për lehtësimin e qarkullimit të automjeteve dhe njerëzve, etj.

Pastrimi I rrugëve bëhet çdo dite prej orës 24.00 deri 06.00. Pastrohen çdo ditë 429861 m2 rrugë dhe trotuare. Transporti I mbeturinave për në fushën e grumbullimit dhe përpunimit të tyre bëhet çdo ditë me mjete teknologjike prej orës 03.00 deri 07.00 për evadimin e mbetjeve nëpër konteniere dhe prej orës 07.00 deri 11.00 për lagjet që nuk kanë konteniere. Cdo ditë evadohen rreth 80 ton mbeturina. Lagia e rrugëve bëhet për periudhën 01.04 deri 31.10 çdo ditë nga ora 06.00 deri 18.00 në një sipërfaqe prej 295,870 m2 si dhe larje speciale e rrugëve me sipërfaqe 70,236 m2 çdo ditë. Grumbullimi I mbeturinave bëhet me rreth 400 konteniere.

Gjithashtu në këtë shërbim hyn edhe pagesa për supervizorin e pastrimit. Fondi I planifikuar për shpenzime për paga për vitin 2013 ka qenë 530 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 507 mijë lekë ose 95.6%.

Fondi I planifikuar dhe realizuar për shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2013 ka qenë 84 mijë lekë.

SPONSORIZIME

Gjatë vitit 2013 ndaj Bashkisë Korçë ka pasur sponsorizime, të cilat kanë qenë detyrim nga viti 2012, dhe janë përdorur sipas destinacionit të përcaktuar nga donatori dhe konkretisht:

Sponsorizim PNUD

1,068,178 lekë nga të cilat:

-703,178 lekë shpenzime operative, realizimi 665,325 lekë. Vlera prej 37,853 lekësh mbetet detyrim dhe do të shlyhet gjatë vitit 2014.

-250,000 lekë transferta, realizimi 250,000 lekë, pagesë për Fondacionin Kennedy për projektin Dhuna në familje.

-115,000 shpenzime kapitale, realizimi 115,000 lekë, e cila është përdorur për blerje karrikesh dhe tavolinash sipas projektit.

ANALIZA E PROJEKTEVE 2013**Festa e Birrës 2013**WWW.festa.e.birres.com**Përshkrim shkurtimisht:**

Projekti “Festa e Birres” i implementuar për të shtatin vit radhazi synoi stimulimin, mbështetjen, promovimin e bizneseve lokale, zhvillimin e turizmit nëpërmjet kthimit të kësaj feste në traditë si dhe gjallërimin e jetës në qytet. Këtë vit festa e birrës, pati një sërë aktivitete të zhvilluara përgjatë 5 neteve 14-18 gusht 2013 në Parkun Rinia të qytetit me një audience masive, jo vetëm nga qyteti i Korçës dhe rrethinat e tij, por dhe me turistët vendas dhe të huaj, të ardhur posaçërisht për të ndjekur këtë event të rëndësishëm. Risi e festës së birrës për këtë vit ishte krijimi për here të parë i një infrastrukture unike për të gjithë birrat dhe bizneset pjesëmarrëse.

Festa e Birrës u mbështet kryesisht nga bizneset lokale si dhe donatorë të ndryshëm. Ky event përveç se përfaqëson një nga eksperiencat më pozitive dhe më të suksesshme të zhvillimit të turizmit, promovon gjithashtu qytetin dhe ato çka ai përfaqëson si një destinacion të rëndësishëm turistik në Shqipëri..

Vlera totale e këtij projekti nga Bashkia: 1 000 000 Lek

**Panairi i fundivit****Përshkrimi shkurtimisht:**

Festimi i festave të fundvitit në Korçë është një nga eventet më të rëndësishme për qytetin. Të qenit kryesisht një komunitet që i do festat, dekorimi i qytetit si asnjëherë tjetër, si dhe eventet e ndryshme që shoqëruan këtë periudhë, bëri që festat e fundvitit të kthejnë Korçën në qendrën turistike të Shqipërisë të festave të fundvitit.

Këtë vit, për të krijuar një ambient ndryshe nga çdo vit më parë si dhe për të përçuar kudo mesazhin se festat e fundvitit festohen më bukur se kudo në Korçë, u zbulua pallati i kulturës “Vangjush Mio”, me qëllim bërjen e tij sa më shumë atraktiv për vizitorët vendas dhe të huaj, si dhe shndërimin e tij në ‘Shtëpinë e babagyshit’. Kjo qëndroi e hapur e hapur për gati dy jave që nga data 21 dhjetor deri në 31 dhjetor dhe do të

mirëpresë të gjithë fëmijët për tu takuar me babagjyshin dhe për të bërë një foto me të. Në zonën këmbësorë do të zhvillohet dhe një mini panair me pije tradicionale si dhe me artikuj të ndryshëm.

Shumë vizitorë vendas dhe të huaj preferuan Korçën si destinacion të pushimeve dimërore. Panairi së bashku me aktivitetet e organizuara si Koncertet apo aktivitetet për fëmijë, si "Parada e Babagjyshit", "Shtëpia e babagjyshit" etj, tërhoqën vëmendjen e qytetarëve dhe të ardhurve në Korçë, në këtë periudhë.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: 600 000 Lek .



Festa e lakrorit

Përshkrim shkurtimisht:

Projekti "Festa e Lakrorit 2013" u implementua për të gjashtin vit radhazi, në formën e një eventi që tërhoqi vëmendjen dhe pjesëmarrjen e shumë vizitorëve, duke konsoliduar profilin festiv të kësaj tradite dhe qytetit të Korçës. Kjo festë tashmë e kthyer në një festë të përvitshme, thekson dhe njëherë mesazhin se Korça është qyteti që ruan dhe zhvillon traditat e saj më të mira duke i kthyer ato në potenciale turistike.

Festa u zhvillua në mjediset e gjelbëruara të Parkut "Rinia", ku gatimi tradicional, lakrori i prodhuar në çast nga amvisat korçare ju servirej qytetarëve. Në aktivitet morën pjesë disa biznese të qytetit si taverna "Troja", "Shaka" Boboshtice, pasticeri Nefeli, etj, të cilat mbështetën financiarisht aktivitetin si dhe tregëtuan produktet e tyre në festë. Ky event u shoqërua me muzikë live, duke sjellë kështu një pasdite ndryshe në qytet.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: 60 000 Lek




Blerja e hartave turistike “Korça, in your pocket”**Përshkrim shkurtimisht:**

Me qëllim pasurimin e materialeve promocionale për qytetin dhe vënien e tyre në dispozicion të turistëve, Bashkia Korçë bleu një sasi prej 100 copë të hartave turistike “Korça, in your pocket”.

Të gjitha atraksionet që janë të publikuara në hartë, kanë një përshkrim të shkurtër, vendndodhjet e tyre përkatese si dhe janë të shoqëruara me një foto. Përveç atraksioneve turistike dhe kulturore të publikuara, harta turistike “Korça, in your pocket” përmban në fund të saj një hartë turistike me informacion orientues për turistët vendas dhe të huaj.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: **20 000 Lek.**

**“Respekt për mësuesit”****Përshkrim shkurtimisht:**

Me rastin e 7 Marsit festës së mësuesve, Bashkia Korçë zhvilloi në ambientet e hotel “Life Gallery” një pritje koktej me mësues korçarë, të cilët kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në edukimin e brezave. Në pritjen e nderit, Kryetari i Bashkisë përcolli urimet dhe falenderimet për këta veteranë të arsimit, të cilët punuan gjithë jetën në këtë profesion kaq të dashur duke edukuar me profesionalizëm, përkushtim dhe fisnikëri disa gjenerata të rinjsh.

Vlera totale e këtij projekti e planifikuar nga Bashkia: **100 000 Lek.**



Projekti Mbështetje shkollore për fëmijët në nevojë

Me fillimin e vitit të ri shkollor 2013- 2014 dhe për t'iu qëndruar pranë fëmijëve në nevojë, Zyra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Komuniteteve në Nevojë, evidentoi problematikën e fillimit të vitit në të gjitha shkollat 9-vjecare të qytetit të Korcës. U vlerësua e domosdoshme pajisja me libra të nxënësve në shkollën 9-vjecare "Naim Frasheri Implementimi i projektit "Mbështetje shkollore për fëmijët në nevojë" bëri të mundur eliminimin e problematikës, duke pajisur me libra 200 fëmijë. Kjo ndikoi drejtpërdrejt në evitimin e braktisjes shkollore tek ata. Bashkia mbështeti me një vlerë prej **100,000 lekë. Përfituesit:**200 fëmijë në nevojë janë përfituesit direkt të projektit, duke përfituar libra të nevojshme për kryerjen e detyrave dhe ndjekjen e procesit mësimor. Po kështu dhe familjarët e tyre. Gjithashtu 30 fëmijë në nevojë përfituan canta shkollore me fondin e Terre des Hommes. UNDP ofroi shumën prej 50 mije lek për pajisjen me tekste shkollore për 20 fëmijë në nevojë nga shkollat e tjera të qytetit.



Qendra Komunitare për të moshuarit .

Qendrat Komunitare janë ideuar dhe hapur nga Bashkia Korçë në vitin 2008 si një vend për të takuar së bashku dhe për të pirë një kafe apo çaj, ku mund të flasim me njëri tjetrin, të luajnë me letra apo domino dhe të lexojnë shtypin e ditës. Në 2010 këto 2 Qendra u morën nën menaxhimin e Fondacionit Kennedy. Dhe në Dhjetor të 2010 u hap dhe Qendra e 3 për Moshën e Tretë duke para nevojën edhe për një qendër tjetër po dhe eksperiencën e fituar tashmë nga puna në 2 qendrat. Të moshuarit shkojnë çdo ditë në këto qendra dhe aty përfitojnë nga shërbimet e ofruara si më poshtë:

- Ofrimi i kafes dhe çajit për çdo të moshuar .
 - Leximi i shtypit të ditës.
 - Shërbime nga 3 kujdestarë të përhershëm.
 - Shërbime të specializuara nga 1 punonjës social për Qendrat komunitare.
 - Shërbime të specializuara nga 1 punonjës animator për Qendrat komunitare.
 - Ndërhyrje dhe vizita mjekësore.

-Ofrimi i një vakti të ngrohtë

-Ekskursion në Voskopojë në muajin gusht.

-Vizita nga këngëtari i shquar anglez Adrian Snell.

-Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Moshës së Tretë pranë ambjenteve të Fondacionit Kennedy u zhvillua një koktej me të moshuarit që frekuentojnë Qendrat Komunitare.

Kokteji u shoqërua me këngë dhe serenata korçarë të kënduar nga pjesëtarë të Grupit Lira. Të moshuarit kënduan së bashku me ta. Në koktej ishin të pranishëm punonjës nga Bashkia Korçë dhe mediat lokale. Gjatë këtij viti ky projekt u realizua në vlerën 550,540 lekë.

28 Nëntor : Ditë Festimi me Rastin e 101Vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë

27- 28-29 Dhjetor : Dreke festive me rastin e Festave të Fundvitit.

Fondi i vënë në dispozicion nga Bashkia për këto 3 qendra shkon në 1 000 000 lek për ofrimin e çaj kafe, shtypi i ditës, qera ambjenti dhe ekskursionet. Fondi prej 1 569 000 lek vënë në dispozicion nga Fondacioni “Kennedy” mbulon shpenzime për ngrohje, stafin dhe një pjesë të kostove të qerasë, çaj, kafe, aktivitete dhe shpenzime të tjera operative.



Projekti “Ndihmë për pleqtë e vetmuar” (bashkëpunim me Dorcas)

Përmirësimi i jetës social-psikologjike të personave të moshuar dhe të marxhinalizuar/vetmuar në qytetin e Korcës për të jetuar me dinjitet dhe vetëvlerësim të lartë, pavarësisht moshës së thyer ishte qëllimi i projektit i cili u implementua për të dytin vit radhazi në bashkëpunim me organizatën Dorcas Albania-Korcë. Dy qendrat e reja komunitare që u ngritën, akomoduan 100 pleq të vetmuar, të cilët për shkak të varfërisë pensionit të ulët, vetmisë, kushteve familjare, jetojnë nën efektet e depresionit, pasigurisë dhe sëmundjeve të patrajuara. Për të zbutur sado pak këtë problematikë që ndeshet në grup moshën e sipër përmendur, u celën në bashkëpunim me Dorcas Albania-Korcë këto dy qendra, ku të moshuarit e vetmuar të kenë mundësi të përfitojnë sa më shumë duke u socializuar me njëri-tjetrin dhe duke përfutur falas një kafe/caj, shtypin e përditshëm, aktivitete të ndryshme psiko-sociale nga e hëna në të premte për të jetuar jetën e tyre me dinjitet dhe vlerësim. Bashkia financoi për këtë projekt me 400,000 lekë, ndërkohë që zuri një pjesë të rëndësishme edhe financimi nga partneri implementues i këtij projekti, në shumën prej 9 399 355 lek nga Fondacioni Emanuel.



Projekti Karta e pensionistit (Karta për moshën e tretë)

Karta e pensionistit e promovuar në prill të vitit 2011, tashmë po hyn në vitin e katërt të zbatimit. Ky projekt ka për qëllim krijimin e një sistemi shërbimesh falas apo me cmime të reduktuara në fusha me interes për të gjithë pensionistet e qytetit të Korcës. Përmes këtij projekti, pas pajisjes me një kartë të personalizuar me fotografi, që ofrohet falas nga Bashkia, **cdo pensionist në qytetin tonë** po përfiton falas shërbimin e transportit urban, ndjekjen e ndeshjeve në stadium dhe në pallatin e sportit, ulje të cmimit të biletës në teatër në masën 50% si dhe ulje në masën 20%- 50% në disa shërbime si në njësi tregtimi, apo shërbimesh të nevojshme për moshën e tretë. Pensionistët përfitojnë gjithashtu disa shërbime e analiza mjekësore falas nga klinika në qytetin tonë. Gjatë vitit 2013 janë shpërndarë 1666 karta për pensionistët, ndërkohë që vazhdojnë aplikimet me një fond prej 250,000 lekë.

Realizimi i këtij projekti po shërben si bazë edhe për projekte të tjera për shërbime komunitare për moshën e tretë të cilat do të përfshihen në kartën e tyre.

Projekti “Kampe verore për fëmijët”

Kampi veror ditor u implementua për të pestin vit nga Bashkia e Korcës në bashkëpunim me Ëorld Vision, UNDP dhe Drejtorinë Rajonale Arsimore. Aktivitetet e implementuara përfshinin ekskursione, mësimet edukuese, shfaqje filmash në kinema, lojra psiko-sociale, inkurajim debatesh mes fëmijëve, etj.

Përvec edukimit jo-formal të fëmijëve qëllime dytësore ishin: promovimi i aktiviteteve ndër-etnike (40 fëmijë romë dhe egjiptiane përfituan nga projekti) dhe mbrojtja e fëmijëve nga rreziqet e rrugës. Vlera e mbështetur nga bashkia në projekt 200 000 lekë, Ëorld Vision 50 000 lekë

Impakti/Perfituesit Gjatë periudhës së verës të implementimit të këtij projekti fëmijët u përfshinë në aktivitete të tilla si ekskursione në Voskopojë, dite të lira në lojrat zbavitëse të qytetit, ushqim ditor (frutë , pije freskuese , hamburger)



Projekti “Festa e 1 Qershorit”

1 Qershori, festa e fëmijëve krijoi një atmosferë festive në qytetin e Korcës. Kjo festë tradicionale e organizuar nga Bashkia në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Korcë, solli veprimtari dhe aktivitete të ndryshme tek Parku Rinia me pjesëmarrjen e të gjithë fëmijëve të kopshteve së bashku me prindërit dhe mësueset e tyre. Aktivitetet e shumta artistike dhe argëtuese si këngë dhe muzike për fëmijë, valle, ekspozim i punimeve në vizatim të fëmijëve të kopshteve, krijuan një atmosferë të bukur që u përcoll nga fëmijë e qytetarë të shumtë si dhe nga mediat lokale. Në këtë aktivitet morën pjesë edhe fëmijët e Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Mihal Grameno”, të cilët dhanë një koncert, të pasur artistik, grupe të ndryshme baleti. Aktiviteti vazhdoi mbasdite në Zonën Pedonale të qytetit me lojëra lëvizore nga animatorët e Fondacionit “Kenedi”, etj. Me rastin e 1 Qershorit, Kryetari i Bashkisë shpërndau dhurata të ndryshme për fëmijët e çerdhës së qytetit. Vlera e projektit ishte 50 000 lekë, fond i Bashkisë Korçë.



Projekti “Qendra komunitare për fëmijët në nevojë”

Qëllimi i realizimit të këtij projekti që u implementua për herë të parë gjatë vitit 2012, ishte krijimi i kushteve të përshtatshme dhe ofrimi i shërbimeve sociale dhe edukative, mjekësore, kulturore dhe argëtuese për fëmijet romë dhe egjiptianë në nevojë. Projekti konsistoi në ngritjen e një qendre komunitare për fëmijët në nevojë e cila do të ofronte shërbime të specializuara, për të reduktuar braktisjen shkollore dhe nxitur afrimin e fëmijëve në mjediset shkollore. Mund të përmendim shërbimin e specializuar nga 2 mësuese të cilat lehtësuan përgatitjen e mësimeve nga fëmijët pas përfundimit të mësimit, shërbimin nga 1 kuzhinierë duke ju ofruar një vakt të ngrohtë ushqimor në ditë, ekskursione dhe aktivitete sociale si dhe vizita mjekësore dhe ofrim i medikamenteve në rast nevojë. Në këtë qendër gjatë vitit 2013 përfituan 30 fëmijë në nevojë, ndërkohë që financimi i bashkisë kapi vlerën prej 339,954 lekë. Bashkia pati si partner bashkëfinancues dhe implementues Fondacionin Emanuel në Korçë.



Bursa për më të mirët

Përshkrimi shkurtimisht

Projekti bëri të mundur stimulimin e nxënësve të shkëlqyer të shkollave të mesme. Ky aktivitet u zhvillua në një nga ambientet e bar "Life Galery". Morrën pjesë të gjithë nxënësit përfitues nga projekti gjithashtu dhe të ftuar të tjerë nga Drejtoria Arsimore, drejtorë shkollash dhe prindër.

U zhvillua një ceremoni gjatë të cilës nxënësve të shkëlqyer të shkollave të mesme ju akordua një bursë mujore. Për realizimin e këtij projekti pati një bashkëpunim me Bankën Amerikane.

Impakti/Perfituesit

Pjesëmarrësit : 37 nxënës (përfitues)

:150 pjesëmarrës të tjerë (mësues, drejtorë, prindër)

37 nxënës të shkollave të mesme u stimuluan nga Bashkia dhe u nxitën për të arritur rezultate të larta dhe në të ardhmen.

Titulli i projekti	Programi	Vlera e projektit	Bashkia	Donator	Koha e Realizimit	Nr.i përfituesve
Bursat per me te miret	Qyteti mbeshtet te rinjte	100.000	100.000		Viti mesimor 2013-2014	37

**Projekti” Dizenjimi I fasadave dhe ndriçimit për restaurimin e Pazarit të Vjetër”**

Me mbështetjen e Bashkisë Korçë, 30 studentë shqiptarë dhe francezë të degës së Arkitekturës dhe Inxhinierisë së Ndërtimit, prezantuan punën e kryer deri tani për studimin e restaurimit dhe rivitalizimit të Pazarit të Vjetër të Korçës. Pas investimit 600 mijë euro të fazës së parë për sistemin e kanalizimeve, ndricimit publik dhe shtrimit me kalldrëm të pazarit, ky studim është një përpjekje serioze për fazat e mëtejshme të restaurimit dhe rivitalizimit të Pazarit të Vjetër të Korçës, faza gjatë të cilave puna do të përqëndrohet në restaurimin e godinave dhe fasadave si edhe në vënien në funksion të ketyre objekteve. Pazarit i Korcës ka vlera unike, dhe restaurimi e vitalizimi i tij do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë jo vetëm në ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore por edhe në zhvillimin e turizmit, zhvillimin ekonomik lokal, rritjen e punësimit etj.

Investimet e Bashkisë për vitin 2013 janë planifikuar në vlerën 107,965 mijë lekë. Sipas programeve:

81,154 mijë lekë infrastruktura rrugore

1,735 mijë lekë administrim i përgjithshëm (blerje paisje)

5,477 mijë lekë shërbime publike

3,000 mijë lekë studime urbanistike

2,073 mijë lekë investime në arsim

14,526 mijë lekë investime në kulturë dhe sport

Realizimi i investimeve sipas programeve jepet i detajuar si më poshtë:

Infrastruktura rrugore

Gjatë vitit ky fond i planifikuar për programin e infrastrukturës rrugore pësoi ndryshime dhe shkoi në vlerën 81,154 mijë lekë dhe realizimi ka qenë në vlerën 22,352 mijë lekë e detajuar si më poshtë: Vlera prej 57,185 mijë lekësh përbën detyrim i cili do të shlyhet gjatë vitit 2014.

Emri i objektit 2013	PL 2013	PL 2013 ndryshuar	Det 2012	Total 2013	Likuidimi 2013	Diferenca	Det 2013
Mbikqyrje I sist asfa rrugë ne blloqet e pallateve Lagjia 15/1shtesa			59,000	59,000		59,000	59,000
Mbikqyrje Punimesh sheshi para Katedrales			449,100	449,100		449,100	445,776
Kolaudim Punimesh Sheshi para Katedrales			84,000	84,000	84000	0	
Rikonstruksion Bulevardi I Shengjergjit (Blerje pllakash)	1,813,096	1,813,096	22,119,800	23,932,896	9846000	14,086,896	14,086,896
Rikonstruksion Sheshi para Katedrales	55,080,904	54,874,904	1,612,105	54,909,418	12316017	42,593,401	42,593,401
Mbikqyrje I sist asfa rrugë ne blloqet e pallateve Lagjia 17/1			45,640	45,640	9640	36,000	
Mbikqyrje I sist asfa rrugë ne blloqet e pallateve Lagjia 15			31,329	31,329	31329	0	
Mbikqyrje I sist asfa rrugë ne blloqet e pallateve Lagjia 15 vazhdim			64,742	64,742	64742	0	
Total infrastruktura rrugore	56,894,000	56,688,000	24,465,716	81,153,716	22,351,728	57,224,397	57,185,073

Rikonstruksioni i sheshit para Katedrales

Vlera e kontratës për këtë objekt është 68,260,418 lekë. Gjatë vitit 2013 vlera e planifikuar për objektin Rikonstruksioni i sheshit para Katedrales ka qenë në vlerën 54,909,418 lekë dhe realizimi ka qenë në vlerën 12,316,017 lekë. Vlera prej 42,593,401 lekësh përbën detyrim i cili do të shlyhet gjatë vitit 2014.

Rikonstruksion i bulevard “Shën Gjergji” (blerje pllakash)

Vlera e kontratës për këtë objekt është 39,709,096 lekë. Për objektin Rikonstruksion i bulevard “Shën Gjergji” (blerje pllakash) ,vlera e planifikuar në vitin 2013 ishte 23,932,896 nga të cilat vlera prej 22,119,800 lekësh ishte detyrim i vitit 2012 dhe vlera prej 1,813,096 lekësh u planifikua për vitin 2013. Gjatë vitit 2013 u realizua vlera prej 9,846,000 lekësh, diferenca prej 14,086,896 lekësh mbetet detyrim për vitin 2014.

Gjithashtu gjatë vitit 2014 do të shlyhen edhe “Mbikqyrja për objektin sistemim asfaltim në blloqet e pallateve Lagjia 15/1 shtesa” në vlerën 59,000 lekë dhe “Mbikqyrja e punimeve sheshi para Katedrales” në vlerën 445,776 lekësh.

Investime në paisje

Fondi i planifikuar për vitin 2013 për blerje paisje ka qenë në vlerën 1,735 mijë lekë nga të cilat 235 mijë lekë ka qenë detyrim nga viti 2012 dhe realizimi në vlerën 235 mijë lekë ose 13.5%. Vlera prej 343 mijë lekësh mbetet detyrim për vitin 2014. Detajimi jepet si më poshtë:

Emri i objektit 2013	PL 2013	PL 2013 ndrysh	Det 2012	Total 2013	Likuidimi 2013	Diferenca	Det 2013
Paisje zyre +grila	480,000	480,000	28,000	508,000	28000	480,000	
Paisje kompjuterike(kompjuter, printer, skaner)	685,000	480,000	207,000	687,000	207000	480,000	343,200
Radio marrëse	140,000	140,000		140,000		140,000	
Paisje qe sigurojne energji për (kaldaje, gjenerator)	95,000	95,000		95,000		95,000	
Paisje te tjera teknike	100,000	305,000		305,000		305,000	
Totali Administrim I pergjithshem	1,500,000	1,500,000	235,000	1,735,000	235,000	1,500,000	343,200

INVESTIMET NE SHERBIMET PUBLIKE

Investimet në shërbimet publike gjatë vitit 2013 ishin planifikuar në vlerën 5,477 mijë lekë nga të cilat 830 mijë lekë përbënte detyrim nga viti 2012 për blerje trualli për zgjerimin e varrezave publike. Realizimi ka qenë në vlerën 1,617 mijë lekë, nga të cilat: 773 mijë lekësh është përdorur për blerjen e truallit prej 97 m2 në lagjen 12 Korçë, 830 mijë lekë janë përdorur për blerje trualli për zgjerimin e varrezave publike dhe 14 mijë lekë kolaudim punimesh pallati 10 rruga M. Shkodrani.

Vlera prej 13,868 mijë lekësh do të jetë detyrim nga viti 2013 i detajuar në tabelën e mëposhtme:

Emri i objektit 2013	PL 2013	Det 2012	Total 2013	Likuidimi 2013	Diferenca	Det 2013
Blerje trualli per zgjerimin e varrezave publike Xhimanki	2,500,000	830,000	3,330,000	830000	2,500,000	2,500,000
Blerje trualli per zgjerimin e varrezave publike						
Blerje trualli ne Lagjen nr 12 te qytetit te Korces	773,000		773,000	773000	0	
Rikonstrukcion godina e UMB	1,260,000		1,260,000		1,260,000	692,807
Blerje paisje për orën e qytetit (masterclock)	100,000		100,000		100,000	0
Mbikqyrje punimesh pallati 10 rruga M Shkodrani						
5% garanci punimesh per banesat me kosto të ulet						10,675,000
Kolaudim punimesh pallati 10 rruga M.Shkodrani	14,000		14,000	14000	0	
Total sherbime publike	4,647,000	830,000	5,477,000	1,617,000	3,860,000	13,867,807

Gjatë vitit 2014 do të shlyhet edhe vlera prej 10,675 mijë lekësh 5% garanci punimesh të institucionit Njesia e Zbatimit të Projektit, i cili u mbyll gjatë vitit 2013 dhe për këtë arsye këto detyrime do të shlyhen nga ana e Bashkisë Korçë. Detajimi sipas firmave jepet si më poshtë:

Firma Beton Plus	3,926 mijë lekë
Firma Konstruksion 93	2,897 mijë lekë
Firma Bregu sh.p.k	3,096 mijë lekë
Firma Xhengo sh.p.k	756 mijë lekë

Studimet

Fondi i planifikuar për studime urbanistike i vitit 2012 ka qenë në vlerën 3,000 mijë lekë. Kjo vlerë nuk u realizua gjatë vitit 2013. Kjo vlerë është e detajuar si më poshtë. Vlera prej 2,990 mijë lekë do të jetë detyrim për vitin 2014 dhe konkretisht:

Projekt Plani	395 mijë lekë
Rregulloret e Planifikimit	215 mijë lekë
Studim urbanistik master plani I qendrës së qytetit	2,380 mijë lekë
Total	2,990 mijë lekë

Tabela e studimeve urbanistike për vitin 2013

Emri i objektit 2013	Det 2012	Total 2013	Diferenca	Det
Politika e zhvillimit të territorit të Bashkisë	400,000	0	0	
Analiza dhe vlerësimi i situatës ekzistuese social ekonomike hapësirë	400,000	0	0	
Vlerësimi Strategjik Mjedisor	400,000	0	0	
Projekt plani	400,000	400,000	400,000	394,800
Rregulloret e Planifikimit	400,000	220,000	220,000	214,800
Plani I investimeve kapitale	300,000	0	0	
Hartimi I hartave	400,000	0	0	
Perpunimi I PPV-së në GIS	300,000	0	0	
Studim urbanistik kontrate shtese master palini I qendres se qytetit		2,380,000	2,380,000	2,380,000
Total studime urbanistike	3,000,000	3,000,000	3,000,000	2,989,600

Investime në arsimin parauniversitar

Investimet në arsim janë planifikuar dhe realizuar për vitin 2013 në vlerën 2,035 mijë lekë e detajuar si më poshtë.

Emri i objektit 2013	PL 2013	PL 2013 ndrysh	Det 2012	Total 2013	Likujdimi 2013
Rikonstruksion catia shkolla N.Veqilharxhi			1,915,680	1,915,680	1,915,680
Mbikqyrja I punimeve shkolla N.Veqilharxhi			49,000	49,000	49000
Kolaudim I punimeve shkolla N.Veqilharxhi			10,000	10,000	10000
Kolaudim punimesh shkolla S Qirazi			60,000	60,000	60000
Total programi I arsimit			2,034,680	2,034,680	2,034,680

Investime në sport

Vlera prej **583,500 lekësh** u planifikua dhe u realizua gjatë vitit 2013 për objektin si më poshtë:

Mbikqyrje për Rikonstruksion pista e Stadiumit	536,000 lekë
Kolaudim për Rikonstruksion pista e Stadiumit	47,500 lekë

Investime në kulturë

Emri i objektit 2013	PL 2013	PL 2013 ndrysh	Likujdimi 2013	Diferenca	Detyrim 2013
Rikonstruksion Busti Th Germenji	400,000	400,000	0	400,000	285,600
Restaurim banesa ku u ngrit flamuri	9,000,000	9,000,000		9,000,000	9,000,000
Rikonstruksion I godines se teatrit A Z Cajupi		2,400,000	1797432	602,568	
Rikonstruksion Biblioteka e femijeve	2,000,000	2,000,000	1612776	387,224	
Kolaudim rikonstruksion I godines se teatrit A Z Cajupi		11,000	10000	1,000	
Kolaudim rikonstruksion Biblioteka e femijeve		10,000	10000	0	
Mbikqyrje rikonstruksion I godines se teatrit A Z Cajupi		65,000	11400	53,600	
Mbikqyrje rikonstruksion Biblioteka e femijeve		56,000	11400	44,600	
Total programi I kultures	11,400,000	13,942,000	3,453,008	10,488,992	9,285,600

